



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE
SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

Nr.Prot.

Tiranë, më _____.____.2016

Lënda: Monitorimi i realizimit të buxhetit të 12 – mujorit, të vitit 2015

Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT

**MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

TIRANË

Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për vitin 2015 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas tetë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- ❖ Siguria Ushqimore
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketing
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore
- ❖ Menaxhimi i Peshkimit
- ❖ Administrimi i Ujrave

Buxheti vjetor 2015, i planifikuar për këto 8 programe, është realizuar si 12– mujor, në masën 97,3 përqind ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti vjetor është 8.420 milion, është realizuar 8.187 milion lekë të detajuar sipas programeve paraqitur në tabelën e mëposhtme.


Nr	Emri i Programit	Buxheti 2015(mln lekë)	Struktura Në %	Fakti 12 mujor 2015		
				Në mln lekë	Në % ndaj buxh	Struk në %
1	Planifikim, Menaxhim , Administrim	257	3	240	93	3
2	Siguria Ushqimore	1662	20	1645	99	20
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	2668	32	2625	98	32
4	Zhvillimi Rural	2835	34	2799	99	34
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	255	3	242	95	3
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	26	0.3	24	92	0.3
7	Menaxhimi i Peshkimit	484	6	479	99	6
8	Administrimi i Ujrave	192	2,7	165	86	1,7
	Totali	8378	100	8219	98	100

Rreth 86 % e totalit të shpenzimeve faktike, të kryera gjatë vitit 2015 e zënë me shpenzimet për programin “ Zhvillimi Rural duke mbështetur, bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun” 34% , “ Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes” 32% dhe “Siguria Ushqimore” 20%, ndjekur nga programet tjera buxhetore, që nga shpenzimet buxhetore zënë një peshë më të vogël në % .

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2015 dhe realizimit faktik të vitit 2015, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Në %

Nr	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve, sipas PBA-së 2015	Struktura e shpenzimeve, sipas buxhetit 2015	Struktura e shpenzimeve faktike për vitin 2015
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	3	3	3
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrotja e Konsumatorit	20	20	20
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	32	32	32
4	Mbështetja e Prodhimeve Bujqësore -Blegtorale	34	34	34
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	3	3	3
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	0.3	0.3	0.3
7	Menaxhimi i Peshkimit	6	6	6
8	Administrimi i Ujrave	2,7	2,7	1,7
	TOTALI	100	100	100



Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015 për këtë program, që përfaqëson **93 përqind** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 94 përqind
- Shpenzimet kapitale 85 përqind
- **Gjithsej 93 përqind**

Për vitin 2015, janë parashikuar 5 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi faktik i 12 mujorit 2015		
		Në milione lekë	Në %	Statusi i realizimit
Funksionimi i kapaciteteve, menaxhimi për implementimin e politikave bujqësore	134	133	99	Plotësisht
Ngritja profesionale e stafit	13	12	92	Plotësisht
Menaxhimi i përgjithshëm i institucionit	68	55	81	Pjesërisht
Detyrime për anëtarësimin në org. ndërkombëtare	31	31	100	Pjesërisht
Përmirësimi i kushteve të punës	11	9	85	Aspak
TOTALI	257	240	93	

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit janë realizuar 100 %, sigurimet shoqërore 100%, shpenzime operative 87 %, investimet 85 %.

Ky program, kishte të planifikuar 2 objekte investimi me vlerë 11 milion lekë, 9 milion lekë

“Kaldajë celiku për lëdjegse(nafte)me fuqi 300 Ke 600”,1 milion lekë i cili u realizua me 66 % dhe “Blerje pajisje kompjuterike”,10 milion lekë me realizim faktik 87 % ndaj planit , është tender i përqëndruar në MB.

2- Programi “Siguria ushqimore”

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujrave dhe molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinare dhe fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për vitin 2015 janë realizuar masat profilaktike veterinare e fitosanitare, programi i monitorimeve të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujrave e molusqeve bivalve, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në database (sistemi RUDA)luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të DB-së e AKU-së.

Produktet e përfituara për periudhën parashikuar për PBA të vitit 2015, të pasqyruara në aneksin bashkëmgjitur janë realizuar si më poshtë:

- Mbi kontrollin e situatës epizootike është përfunduar zbatimin i programit të vaksinimit kundër sëmundjes së plasjes ku janë vaksinuar 398279 krerë të imtave realizimi 114 % dhe 40227 krerë gjedh realizimi75%.
- Përfundoi vaksinimi kundër murtajës klasike të derrave realizmi 98% ku janë vaksinuar 43250 krerë derra.
- Është përfunduar vaksinimi i brucelozës së remontit në të imta në bashkëpunim me projektin PAZA “ Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike” . realizuar 99% ku jane vaksinuar 594960 krerë të imta (remont).
- Përfundoi gjurmimi për sëmundjen e tuberkulozit në gjedh vetëm në fermat mbi 20 krerë gjedh ku janë gjurmuar 32442 krerë 103%
- Është realizuar programi i monitorimit të mbetjeve në kafshë dhe produkte me orgjinë shtazore 100% si dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujrave të brendshëm .
- Eshtë realizuar programi i identifikimit të kafshëve, në identifikimin e 20% të remontit, gjedhë e të imta ku janë matrikulluar 40500 krerë gjedh 53% dhe 317104 krerë të imta 50%.

- Janë realizuar shpenzimet operative, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2015 për DRB-të , ISUV, dhe AKU .
- Janë realizuar sipas parashikimit shpenzime të investimeve në zërat TVSH dhe kosto lokale, pasi kjo lidhet me zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilëve ka përfunduar.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi i vitit 2015		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Legjislacion i përafuar me aktet normative të BE-së	0	0		
Kafshë të identifikuar në gjithë vendin - Gjedhë remonti - Të imta	88,5	88	100	Plotesisht
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në kafshë e produkte prej tyre	25	25	100	Plotesisht
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në ujëra e molusqe bivalve.	6	3	50	Pjesrisht
Sëmundje në kafshë, të monitoruara - Kafshë të ujit				
-Kafshë të Tokës	10	10	0	
Derra të vaksinuar k/murtajës klasike.	4	4	50	Pjesrisht
Të imta të vaksinuara k/ brucelozës (Rev1).	31	30	99	Plotesisht
Vaksinim kundër tërbimit	0	0		
Kafshë gjedhë të gjurmuara për tuberkuloz.	7	3	47	Pjesrisht
Kafshë gjedhë të gjurmuara për bruceloze				
Kafshe gjedhe te vaksinuar k/brucelozës Emergj.veterinare				
Kafshë gjedhë vaksinuar k/plasjes.	4	2	50	Pjesrisht
Kafshë të imta, etj, vaksinuar k/plasjes.	18	18	100	Plotesisht
Kafshë gjedhë të eliminuara si të infektuara nga bruceloza, plasja, tuberkulozi.	16	5	31	Pjesrisht
Kafshë të imta të eliminuara si të infektuara				
Rrënjë ullinj dhe pemë frutore të trajtuara k/mizës dhe f. bardhë të manit.	7,5	7	100	Plotesisht
Pemë frutore të asgjësuar si të infektuara.	2	2	100	Plotesisht

Sipërfaqe e trajtuar k/ miut të arave dhe karkalecit.	78	78	100	Plotesisht
Zonë e paster.	2	2	100	Plotesisht
AKU e plotësuar me kapacitetet për funksionimin e plotë - Paga	362	354	98	Plotesisht
- operative	88	86	98	Plotesisht
- investime	10	10	100	Plotesisht
- trajnim, sensibilizim	0	0		Plotesisht
Instituti i Sigurisë Ushqimore i fuqizuar dhe me kapacitete të plotësuara- Paga	82	82	100	Plotesisht
- operative	32	30	99	Plotesisht
- investime	30	29	98	Plotesisht
DRBU-të në qarqe të plotësuara me kapacitetet e nevojshme funksionale- Paga	368	363	98	Plotesisht
- operative	133	122	92	Plotesisht
-investime	93	82	88	Plotesisht
Financim i huaj Dhe tvsh	165	202	122	Plotesisht
TOTALI	1662	1645	99	

Referuar projekteve të investimeve të huaja si:

- ✓ **Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, për luftimin e sëmundjeve zoonotike, faza II, IPA 2012 me plan 95 milion lekë, realizuar 132 milion lekë pra me realizim 139 %.**

Projekt i mbyllur si fazë e parë. Një nga arritjet kryesore të Projektit PAZA ka qenë harmonizimi i sistemeve ekzistuese në sektorin e blegtorisë, duke krijuar bazën e të dhënave RUDA. Baza e të dhënave RUDA, përmban të dhëna mbi regjistrin kombëtar të fermave dhe të dhëna të detajuara mbi regjistrimin dhe lëvizjet e gjedhëve dhe të imtat. Sistemi RUDA, përfshin edhe të dhëna vjetore mbi vaksinimet e realizuara dhe matrikullimin e përvitshëm në blegtori. Një nga veprimtaritë më të rëndësishme të realizuara nga projekti ka qenë fushata kombëtare për vaksinimin kundër brucelozës në të imta. Me bashkëfinancimin e ministrisë, është kryer procesi i vaksinimit të bagëtive të imta kundër brucelozës. Realizimi i këtyre objektivave është shoqëruar me një trajnim të strukturave publike dhe të veterinerëve privat që kanë qenë pjesë e fushatave.

3. Programi “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes”

Ky është një nga programet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, si një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor. Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015, për këtë program, që përfaqëson rreth 98 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 98 përqind
- Shpenzimet kapitale 99 përqind
- **Gjithsej 98 përqind**

❖ Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore janë realizuar 98 % të fondit vjetor të planifikuar, shpenzimet operative 98 %, ndërsa investimet si realizim financiar paraqiten në 99%.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi i vitit 2015		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes				
Rrjeti i kanaleve kullues i mirëmbajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia)	307	300	98	Plotësisht
Rrjeti i kanaleve ujitës i mirëmbajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia)	228	223	98	Plotësisht
Argjinatura të mirëmbajtura në mënyrë rutine	56	54	96	Plotësisht
Shërbimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovore	445	439	99	Plotësisht
Inspektime teknike të sigurisë së digave	9	9	100	Plotësisht
Inspektime teknike të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja në zonën e shërbimit të ujitjes 360 000 ha dhe zonën e shërbimit të kullimit 280 000 ha përfshi dhe 28 hidrovoret	9	9	100	Plotësisht
Rrjete të përmirësuara të kanaleve të kullimit	9	9	100	Plotësisht
Rrjete të kanaleve ujitëse të rehabilituara dhe përmirësuara	700	699	100	Plotësisht
Diga të rezervuarëve të rehabilituara pjesërisht	85	83	98	Plotësisht
Diga të rezervuarëve të rehabilituara plotësisht	670	669	100	Plotësisht
Argjinatura të reja të ndërtuara	48	39	81	Plotësisht
Argjinatura të rikonstruktura	33	25	76	Plotësisht
Argjinatura të rehabilituara	60	58	97	Plotësisht
Hidrovore të rikonstruktuar dhe ripërshtatur	9	9	100	Plotësisht
TOTALI	2668	2624	98	

Ndër treguesit kryesorë të realizuar gjatë vitit 2015 përmendim:

- Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes dhe futjen për herë të parë nën ujitje të rreth 14

000 ha tokë bujqësore, në raport me 8300 ha të planifikuara për vitin 2015 dhe rreth 5000 ha të vitit 2014.

- Rehabilitimin e 26 digave, nga të cilat 11 diga janë rehabilituar plotësisht në kuadër të Projektit të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Bankës Botërore, ndërsa në 15 diga të tjera është rritur siguria e tyre
- Janë pastruar rreth 808 km kanale ujitëse duke lëvizur rreth 500 000 m³ dhera, me ndikim në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes në një sipërfaqe rreth 80 000 ha. Kjo në raport me rreth 320 km kanale ujitëse të pastruara në vitin 2014.
- Janë pastruar rreth 430 km kanale kryesore kullues dhe kanale të ujërave të larta duke lëvizur rreth 1.9 milion m³ dhera, duke ndikuar në përmirësim e treguesve të kullimit në rreth 50 000 ha.
- Rehabilitimi/rikonstruksioni i rreth 2.2 km argjinatura mbrojtëse në lumenjtë Bun në Shkodër, Seman në Fier dhe sistemimi i shtratis të lumit Drinos në Gjirokastrë.
- Rikonstruksioni i sistemit elektrik të tensionit të ulët të hidrovorit të Porto Romanos në Durrës.
- **Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes ka realizuar 99.94 % te buxhetit te planifikuar per vitin 2015.**

Objektivat e Zhvillimit të Projektit për të krijuar kuadrin strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drin-Buna dhe Semani dhe të përmirësohet, në mënyrë të qëndrueshme performanca e sistemeve të ujitjes në zonën e projektit. Janë rehabilituar 11 diga ka përfunduar zbatimi i kontratave të punimeve civile, Janë finalizuar të gjitha procedurat e prokurimit për aktivitet sipas planit të prokurimit për vitin 2015. Projekti ka hyrë në fazën e jetësimit të objektivave, kryerjes së investimeve si punimeve civile per rehabilitimin e digave si dhe financimit të aktiviteteve të tjera mbështetëse. Deri tani janë nënshkruar 31 kontrata. Për vitin 2015 per te dy programet Infrastruktura Ujore dhe Administrimi i Ujerave është parashikuar financim i huaj dhe i brendshem në vlerën 907,4 mil leke (sipas aktit normativ). Kontratat më të rëndësishme në proces implementimi dhe që kanë efekt direkt në realizimin e objektivave të projektit janë:

- - “Rehabilitimi i 11 digave”, deri tani jane realizuar 100% e punimeve faktike nga informacioni i supervizorit të punimeve dhe eshte disbursuar 80% e kontratës,
- - Shërbimi i përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe projekteve të zbatimit për sistemet e ujitjes dhe kullimit. Ka përfunduar studimi i fizibilitetit për skemat ujitëse, ndërsa projektet e zbatimit përfundojnë në gjashtemujorin e pare 2016.
- - Përgatitja e Strategjisë për Ujitjen dhe Kullimin – është përgatitur drafti i parë i dokumentit të strategjise.

- - Përgatitja e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore – drafti strategjia është dorëzuar nga konsulentët dhe është në process miratimi,
- - Përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve për basenet e Drini-Buna dhe Semani – është dorëzuar raporti praparak nga konsulenti, drafti i parë i dokumentit të planeve të baseneve pritet brenda 12 muajve.
- - Krijimi i kadastrës ujore, kontrata është në zbatim.

4. Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”.

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2015, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” ju alokuan gjithsej 2,835 milion lekë dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente	1,944 milion lekë
- Shpenzime kapitale	891 milion lekë

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015, për këtë program, që përfaqëson rreth 99 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korrente	99 përqind
• Shpenzimet kapitale	99 përqind
• Gjithsej	99 përqind

Realizimi sipas produkteve :

Për “ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë“. Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Buajt, Bagëtitë e Imta, si dhe shpenzimet për përmirësimin racor. Me VKM nr.1634 datë 17.12.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”, si dhe urdhërit të Ministrit nr. 84 datë 02.03.2008, janë përcaktuar të gjitha procedurat dhe tarifat për këtë qëllim. Kështu për vitin 2015 u alokuan fonde për buajt prej 3 milion lekë në tre qarqe të vendit atë të Lushnjës, Elbasanit dhe Tiranës. Upunua me plotësimin e kartelave dhe çertifikatave veterinarë të tyre.. Gjithashtu mbështetur në VKM nr.1708 datë 29.12.2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr.4 datë 18.08.2009, të ndryshuar, janë parashikuar 1.5 milion lekë, për financimin e racave në rrezik zhdukje në Elbasan dhe Shkodër. Është ecur paralelisht me matrikullimin e bagëtive në këto qarqe.

Gjithashtu është planifikuar një fond prej 3.65 milion lekë për përmirësimin racor në DRB-të e 5 qarqeve, me qëllim përmirësimin, rregjistrimin dhe rritjen e cilësisë së mishit nga bagëtitë. i cili u realizua në masën 79% në përputhje me nevojat reale të evidentuara..

Promovim i produkteve shqiptare te sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, përmes pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare :

Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2015 janë realizuar 16 panaire ndërkombëtare dhe kombëtare. Gjithashtu këtë vit u krye dhe promovimi me anë të tregjeve lëvizëse si dhe tregjeve të hapura. Sipas urdhërit të ministrit, u organizuan pjesëmarrja në panirin “Green Eëek 2015”, Berlin Gjermani. Gjithashtu ka përfunduar organizimi dhe kryerja e panaireve: “Gërshëra e Artë”, organizuar në Elbasan, “Promovimi i produkteve tipike të zonës së Mokrës”, Pogradec, “Promovimi i Agroturizmit, Prezë” Tiranë, EXPO Milano 2015, e cila u hap me datë 1 Maj 2015, për organizimin e aktiviteteve në kuadër të “Muajve të Bujqësisë”<panairii Agroturizmit Berat;Panairi i Veres,panairi i vajit te ullirit;Ekspozite e produkteve shqiptare ;promovim i sektorit të qumështit, Lushnje;konkurdsi i Verës;Degustimi i vajit të Ullirit;promovim i sektorit të peshkimit dhe akuakultures ne Shqipëri, Vlorë. Ky zë është realizuar 70 % e fondit të alokuar.

Mostra të degustuara të duhanit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të konsumatorit, produkt ky i cili realizohet nga Agjensia Kombëtare e Duhan Cigareve. Këtë vit u punoat në drejtim të përmirësimit të prodhimit përmes futjes së kultivarëve të mirë të farës së duhanit për monitorimin tërësor të prodhimit, grumbullim-përpunimit dhe eksportit, përmes promovimit të teknologjive të reja; demonstrimeve, testimeve; etj. Do të vazhdojë puna gjithashtu dhe në drejtim të përditësimit të të dhënave të regjistrit Kombëtar të Prodhuesve të duhanit. Aktualisht janë kryer vetëm pagesat e detyrueshme si dhe ka filluar puna në terren (Stacioni i Duhanit Cërrik). Janë grumbulluar mostrat e para dhe janë kryer 135 degustime.

Realizimi i shpenzimeve është 79%

Numër fermerësh burra e gra, përfitues të skemave kombëtare. Për vitin 2015 për skemat mbështetëse është planifikuar fondi prej 1 670 milion lekë duke përfshirë këtu dhe fondin e planifikuar prej 121.4 milion leke si bashkëfinancim në kuadër të projektit IPA 2011 dhe Protokolli Italian për ullinjë.

Është parashikuar një ndryshim thelbësor në hartimin e skemave mbështetëse, duke i dhënë përparësi jo më mbjelljeve direkte por **finalizimit të produktit**. Është realizuar një numër më të lartë të projekteve përfituese me rreth 11875 aplikues nga 9200 aplikues te planifikuar. nga të cilat 519 janë aplikuese gratë. Gjatë kësaj periudhe janë kryer një numër i lartë kontrollesh, duke mundësuar kështu disbursimin e fondeve për një numër të konsiderueshëm projektesh.

Vrojtime statistikore: Për këtë vit janë parashikuar shpenzimet për kryerjen e vrojtimeve statistikore. Akoma nuk është kryer asnjë shpenzim. Pasi kishte mungesë të strukturës implementuese në MBZHRAU(sektori i statistikave)

Farëra gruri, misri, patate, perime të tjera, bimë medicinale, etj, të analizuara, testuara dhe certifikuara, realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve. Realizimi i fondit për v.2015 është 99%%. Janë kryer 2010mostra me 3 deri 4 tregues për mostër në funksion testimesh dhe kontrollesh të fidanëve të ullirit, të pemëve frutore dhe hardhive. Duke vënë theksin në rritjen e cilësisë së farës dhe fidanit,

Sipërfaqe vreshti e rregjistruar, për 4000 njësi vreshti (kadastra e vreshtarisë dhe verës). Me përfundimin e projektit të BE-së për krijimin e kadastrës së vreshtarisë dhe verës, duhet të përfundojë dhe të vazhdojë puna për rregjistrimin e gjithë sipërfaqes së mbetur dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngritur.

Sipërfaqe ulliri e rregjistruar nga QTTB Fushë-Krujë. U realizuan të mbulohen këtë vit 4586 njësi ullinj. Dhe për mirëmbajtjen e sistemit të ngritur puna është në vazhdimësi.

Rregjistrim të dhënash për kafshët, fond që menaxhohet nga QTTB Fushë-Krujë, për rregjistrimin e gjethit, bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoritë e Bujqësive në rrethe. Jemi në fazat e para të procesit. Produkti është realizuar në masën e parashikuar .

Përmirësim i jetesës në zonat rurale, përmes ndërhyrjes me fonde të donatorëve të huaj. Kështu për vitin 2015 janë planifikuar të veprojnë në këtë program, një sërë projektesh si: Projekti IPA 2011 IPARD Like; IPA 2012, Projekti SARED, si dhe tre projektet e Protokollit Italian: Fuqizimi i AZHBR-së, Mbulimi i Rreziqeve në Bujqësi, si dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm i Sektorit të Ullinjve në Shqipëri. Gjithashtu në këtë grup bën pjesë dhe projekti MADA si dhe Granti Francez, të cilët kanë pasur dhe disbursim për 12 mujorin, sipas aktiviteteve të planifikuara.

Studim per kapacitetet kullosore. Ishte parashikuar një studim për kapacitetet kullosore në Shqipëri. I cili nuk u realizua

Fuqizimi i kapaciteteve të MBZHRAU, përmes implementimit të projekteve të huaja që veprojnë në këtë fushë. Specifikisht janë si më poshtë:

- ✓ **Protokollet Italiane, realizim 94%,** të cilat janë për fuqizimin e AZHBR-së, Mbulimin e Rreziqeve në Bujqësi, si dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Ullinjve në Shqipëri, janë zhvilluar katër mbledhje të komitetit të drejtues sipas axhendës të rënë dakord me palën italiane (ngritja e grupit të punës cili do të ndjekë

zbatimin e projektit, termat e referencës për koordinatorët shqiptarë të projekteve, termat e referencës për ekspertët italianë si dhe termat e referencës për kompaninë e auditimit). Janë plotësuar dhe firmosur të gjithë formularët për nënshkrimin e disbursimit të fondeve nëpërmjet Ministrisë së Financave, si dhe janë njoftuar të gjithë kandidatët fitues për themelimin e njësive të menaxhimit të projekteve.

- ✓ **Protokolli Italian Programi Fuqizimi i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor Rural për disbursimin e Granteve në Bujqësi** . Objektivi i përgjithshëm i projektit “Fuqizimi i Agjencisë së Pagesave Shqiptare - AZHBR - për lëvrimin e kontributeve në bujqësi” synon të ndihmojë në mbështetjen e Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit evropian dhe, në veçanti, në adaptimin e *acquis communautaire* në fushën e bujqësisë, duke përmirësuar administrimin e kontributeve për ndërmarrjet bujqësore dhe të ardhurat e tyre. Projekti ka nisur aktivitetet e tij në muajin mars 2015 me kapacitet dhe personel të plotë. Realizimi financiar është 99 %.
- ✓ **Protokolli Italian-Projekti pilot për krijimin e eksperimentimit të një sistemi të sigurimeve të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi** Objektivi kryesor i projektit: Hedhja e bazës për ngritjen e një sistemi të sigurimit të prodhimeve bujqësore nga fatkeqësitë natyrore duke përfshirë edhe një pilotim të një skeme: dëmtimin e vreshtave nga breshëri. Projekti ka nisur aktivitetet e tij në muajin mars 2015 me kapacitet dhe personel të plotë. Aktualisht nuk kapitur problematika, realizimi financiar 95 %.
- ✓ **Projekti IFAD programi zonat malore drejt tregut (MMP-ja) është realizuar 100 % nuk ka problematikë**. Ecuria e projektit është në përputhje me planin e donatorit.
- ✓ **Projekti “Fondi i Garancisë për Kreditë Rurale IPA 2012”**. Objektivi i projektit është të kontribuojë në thellimin e Sektorit Financiar Shqiptar në zonat rurale dhe në përmirësimin e konkurrueshmërisë së Sektorit Bujqësor në përputhje me objektivat strategjike të procesit të antarësimit në BE. Realizimi financiar si vit 100 %. Janë përcaktuar fushat për një bashkëpunim të suksesshëm të IPARD në të ardhmen, duke pasur të gjithë aktorët kryesorë të cilët kanë përfituar përvojë praktike dhe njohuri mbi zbatimin e projekteve të IPARD-Like, SARED etj. Nga ana e KE-se është kryer disbursimi i fondeve në bank pra dhe ngurtesimi i tyre në funksion të qëllimit të projektit.
- ✓ **Projekti “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural” Sared**” Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti do të synojë përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale duke rritur konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe agro-ushqimor nëpërmjet zbatimit të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural. Realizimi financiar

121 %.Mbështetja e Qeverisë Daneze dhe Gjermane për dhënien e gradeve në bujqësi në 4 zinxhir vlerash, në 6 rajone të Shqipërisë, u mundësuan 2 thirrje të projektit dhe u lidhën kontratat për 96 aplikantë, kryesisht për blerje makineri dhe pajisje bujqësore (traktore, plugje, korrëse barietj).

- ✓ **Projekti për biodiversitetin “Granti Francez” është realizuar 84%,** pasi ky projekt në fillimet e tij ka pasur vonesa sidomos në lidhje me dhënien e miratimit nga donatori lidhur me kontratat. U kryen disa studime për 25 zinxhir vlerash, në zonat verilindore të vendit (Kukes, Has, Tropojë) si dhe mbështetje për infrastrukturën rurale. disa kontrata studimi mbi cilësinë e produkteve Bio të Veriut të Shqipërisë.
- ✓ **Projekti Adriatik-Jon Valorizimi i produkteve IPA II është realizuar 11 %** ka pasur takimin e parë të projektit në Kroaci etj.
- ✓ **IPA 2011,IPARD LIKE 1 Realizimi financiar 100%**

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi vjetor 2015		
		Në milion lekë	Në %	Statusi i realizimit
Ruajtja e resurseve gjenetike në ferme (bujt, te imta, etj).	8	7	88	Plotësisht
Promovimi i produkteve shqiptare të sektit bujqësor, blegtoral dhe agrop. në përmes kombëtare e ndërkombëtare.	20	14	70	Plotësisht
Mostra të degustuara të duhanit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të konsumatorit	35	28	80	Plotësisht
Numer fermerësh burra e gra përfitues të skemave kombëtare.	1553	1544	99	Plotësisht
Numer vrojtimesh bujqësore të kryera.	1,5	-	0	Aspak
Farëra gruri, misri, patate, perime të tjera, bimë medicinale, etj të analizuar, testuar dhe certifikuar.	30	26	87	Plotësisht
Efektiviteti i rritur të punës së AZHBR përmes kontrolleve të kryera.	290	289	100	Plotësisht
Sipërfaqe vreshti të regjistruar	10	8,5	85	Plotësisht
Sipërfaqe ulliri të regjistruar	10	9	90	Plotësisht
Fidane të prodhuar nga sera mëmë, sipas varieteteve autoktone	7,2	6,2	86	Plotësisht
Rregjistrimi të dhënash për kafshët.	0,5	0,5	100	Plotësisht
Përmirësimi i jetesës në zonat rurale, përmes ndërhyrjes me fonde të donatoreve të huaja.	872	868	99	Plotësisht
Studim për kapacitetet kullimore	2	0	0	Aspak
Sistemi për dixhitalizimin e të dhënave të agroindustrisë	14,5	0	0	Aspak
TOTALI	2835	2799	99	

5. Programi “ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor ”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015, për këtë program që përfaqëson rreth 40 % përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 96 përqind
- Shpenzimet kapitale 92 përqind
- **Gjithsej** 95 përqind

Në këtë program në kuadër të PBA-së, kanë qenë parashikuar 7 produkte, ecuria e të cilave jepet nga tabela bashkëngjitur.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi i v. 2015		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Teknologji dhe paketa teknologjike (elementë të përmirësuar) dhe studime të ofruara	122	119	98	Plotesisht
Ofrim shërbimesh ekstensionit	53	51	96	Plotesisht
Të ardhura të realizuara nga QTTB	32	28	88	Plotesisht
Transferta për buxhetet familjare	0,3	0,3	100	Plotesisht
Mjete dhe agregate bujqësore të blera	21	20	95	Plotesisht
Sisteme ujitëse të instaluar	19	16	84	Plotesisht
Paisje laboratorit të blera	8	8	100	Plotesisht
TOTALI	255	242	95	

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Ekstensionit dhe Informacionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektori përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), gjatë këtij viti e kanë përqendruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar për vitin 2015.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti: Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të vitit 2015, janë realizuar në masën 97% krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2015, janë planifikuar dhe janë realizuar 15 teknologji/paketa teknologjike (elemente të përmirësuar), si dhe 2 studime në fushën e tokave. Aktivitetet që i shërbejnë këtij produkti janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farave dhe fidanëve si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Produkti: Ofrim shërbimesh ekstensionit: Shpenzimet për këtë produkt për vitin 2015 janë realizuar në masën 97%. Aktivitetet që i shërbejnë këtij produkti ishin: 22 kërkime në nivel ferme që u realizuan nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnimet nga QTTB-të, Universiteti

Bujqësor dhe projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar. Janë realizuar 150 ditë persona të trajnuar të planifikuara për vitin 2015, Sipas planifikimit u përgatitën e 7 tituj broshurash teknike sipas nevojave të fermerëve me tirazh 5200 kopje. Aktualisht janë në proces shpërndarje.

Produkti: Të ardhura nga QTTB-të të realizuara.

Bazuar në Plan bizneset e QTTB-ve për vitin 2015, realizimi i të ardhurave, vjen kryesisht nga: prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, etj.

Përdorimi dhe realizimi i të ardhurave nga QTTB-të në përfundim të vitit 2015, është në masën 28148 mijë lekë nga 31600 mijë lekë që është limiti i përdorimit të këtyre të ardhurave, pra 90%. Gjatë vitit 2015, QTTB-të kanë kryer shpenzime për punimet bujqësore dhe vënien në punë të hapësirave e aseteve që zotërojnë, si dhe kanë realizuar të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore, farërave, fidanëve, nga kryerja e analizave laboratorike, hartografia dhe nga shpërndarja e shitja e materialit biologjik etj. Diferencat në përdorimin e limitit të të ardhurave kanë ardhur kryesisht nga mosrealizimi i të ardhurave nga QTTB Shkodër për shkak të mosrealizimit të prodhimit të farës së misrit hibrid (si pasojë e temperaturave të larta në fazën e pllenimit) dhe QTTB Korçë nga mosrealizimi i prodhimit (për arsye të kushteve të papërshtatshme klimaterike) e për pasojë dhe të të ardhurave të planifikuara në kulturën e jonxhës; si dhe pjesërisht nga: realizimi i një sasive të ardhurash nga shitja e ullirit dhe rrushit në fund të vitit (të ardhura që për arsye të limitit mujor nuk janë përdorur dot, por janë derdhur në buxhet) nga QTTB Vlorë dhe mospërdorimi i limitit për pagat e punonjësve me kontratë nga QTTB Lushnjë.

Produkti “Mjete dhe Agregate Bujqësore të blera”.

Gjatë vitit 2015, ishin planifikuar dhe janë blerë 16 mjete dhe agregate bujqësor. Për këtë produkt janë alokuar 20600 mijë lekë. Ky produkt, gjatë vitit 2015 është realizuar në masën 19559 mijë lekë, pra afërsisht 95%.

Diferenca rezulton të jetë diferencë për shkak të prokurimit me vlerë më të ulët

Produkti “Sisteme ujitëse të instaluar”.

Për këtë produkt, në vitin 2015, ishin planifikuar dhe alokuar 18900 mijë lekë. Në përfundim të vitit 2015 janë realizuar 16184 mijë lekë ose 86% e vlerës së alokuar për këtë produkt. Në terma fizikë, është realizuar blerja e 24 pajisjeve për sistemin ujitës nga QTTB Shkodër; hapja e 5 puseve dhe instalimi i rrjetit elektrik dhe hidraulik në QTTB Vlorë, si dhe hapja e 1 pusi e instalimi i një impjanti në QTTB Korçë.

Diferenca rezulton të jetë diferencë për shkak të prokurimit me vlerë më të ulët

Produkti “Blerje Pajisje Laboratori”

Për vitin 2015, blerja e pajisjeve laboratorike nga QTTB Fushë Krujë, e planifikuar në vlerën 8500 mijë lekë dhe e prokuruar në vlerën 8190 mijë lekë, është realizuar dhe disbursuar në masen 100% të vlerës së prokurimit.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë këtij viti, Strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në qarqe kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panaire, tavolina të rrumbullakëta, etj. Këto aktivitete kishin si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve.

Nga strukturat e shërbimit Këshillimor janë kontaktuar direkt dhe indirekt dhe kanë marrë informacion gjithsej **76000 fermerë** dhe agrobiznese, nga **68000 fermerë** dhe agrobiznese të synuara.

Krahasuar me totalin e numrit të fermerëve dhe agrobizneseve prej 355000, numri i fermerëve të kontaktuar dhe që kanë marrë informacion nga strukturat e shërbimit të Ekstensionit për vitin 2015 është **21 %**.

Gjatë vitit 2015, janë realizuar **150 ditë trajnime** të hapura me specialistë të bujqësisë nga **150 ditë** të planifikuara si dhe **1440 ditë trajnime** me fermerë të interesuar kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, zhvillimit rural, për ndryshimet klimatike etj.

Janë realizuar **1500 demonstrime**. Po kështu, janë shpërndarë për të interesuarit **33500 copë fletëpalosje** për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimin e integruar të fermës, bujqësinë biologjike etj.

Janë realizuar gjatë vitit **140 kronika** dhe **emisione** televizive.

6. Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015, për këtë program që përfaqëson rreth 92 % përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	94 përqind
• Shpenzimet kapitale	90 përqind
• Gjithsej	92 përqind

Për vitin 2015, si 12 mujor janë realizuar:

1-Krijimin e sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe integrimin në sistemin e informacionit (GIS).

-Plani 2015, 50 000 ha tokë bujqësore me një fond financiar (602) prej 18.5 milion;

-Realizimi si 12 mujor 53.388 ha me nje fond prej 17.870 milion lekë e përqëndruar në komunat/bashkitë e mëposhme (tabela nr. 1)

Nr.	Rrethi	Komuna/Bashkia	Sipërfaqja e tokës bujqësore (në Ha)
1	Lushnje	Divjakë	5151.5
2	Lushnje	Lushnje	2551.9
3	Lushnje	Allkaj	1906.4
4	Lushnje	Dushk	3262.8
5	Lushnje	Fier-Shegan	3026.9
6	Lushnje	Golem	4192.0
7	Lushnje	Grabian	2804.6
8	Lushnje	Gradishte	4149.5
9	Lushnje	Hysgjokaj	1541.3
10	Lushnje	Karbunare	4397.6
11	Lushnje	Kolonje	2856.1
12	Lushnje	Krutje	4048.1
13	Fier	Qendër	2669
14	Fier	Dërmenas	5248
15	Fier	Topojë	5583
Shuma			53388.7

Diferenca është si rezultat i vlerës së ofertës të paraqitur nga operatori fitues në tender në shumën 630 mije leke.

2-Dixhitalizimi i Regjistrit të Tokës Bujqësore (RTB)

-Plani në 2015, në 40 njesi të qeverisjes vendore me një fond (602) prej 2.5 milion leke.

-Realizimi, në 40 njësi të qeverisjes vendore me nje fond prej 2.3 milion lekë sipas tabelës 2

Nr.	Qarku	Komuna/Bashkia
1	Dibër	Lis
2	Dibër	Xibër
3	Durrës	Rrashbull
4	Elbasan	Grekan
5	Elbasan	Shezë
6	Elbasan	Gjocaj
7	Elbasan	Kajan
8	Elbasan	B. Peqin
9	Elbasan	Qendër
10	Elbasan	Qukës
11	Elbasan	Orenjë
12	Elbasan	Pajovë
13	Elbasan	Përparim
14	Fier	Greshicë
15	Fier	Hekal
16	Fier	Qëndër
17	Fier	Aranitas
18	Fier	Kutë
19	Gjirokastrë	Buz
20	Gjirokastrë	Dropull i Poshtëm
21	Gjirokastrë	Krahas

22	Korçë	Buçimas
23	Korçë	Barmash
24	Korçë	Bilisht
25	Korçë	Gorë
26	Korçë	B. Ersekë
27	Korçë	Voskopojë
28	Korçë	Miras
29	Korçë	Novoselë
30	Korçë	Dardhas
31	Lezhë	Mamurras
32	Lezhë	Fan
33	Lushnje	Kolonjë
34	Tiranë	Vaqar
35	Vlorë	Konispol
36	Vlorë	B. Sarandë
37	Vlorë	Aliko
38	Vlorë	Vllahinë
39	Vlorë	Lukovë
40	Vlorë	Novoselë

3- Për përmirësimin e funksionimit të laboratorit të GIS është bërë blerja e paisjeve (kompjuter, skaner, plotër dhe fotokopje) me një plan prej 4 milion leke, realizuar 3.6 milion lekë.

4-Objekti i tjetër është përmirësimi i dokumentacionit kadastral në disa qarqe të vendit (Fier, Berat, Dibër, Korçë, Vlorë) për paisjen e tyre me harta (HK dhe HTR) me një fond (602) prej 1 milion lekë. Realizuar si 12 muor 543.2 mijë leke sipas qarqeve (tabela 3).

Nr.	Emërtimi	Plani 000/ leke	Realizimi 000/leke	Diferenca (+,-)	
1	Qarku Berat	200	98	102	
2	Qarku Dibër	100		100	
3	Qarku Fier	300	230.4	69.4	
4	Qarku Vlorë	100		100	
5	Qarku Korçë	100	90	10	
6	Qarku Lezhë	200	124.8	75.2	
	totali	1000	543.2	456.8	

Mos realizimi në këtë zë ka ardhur nga Qarku Vlorë dhe Qarku Dibër që nuk zhvilluan tenderin si rezulta i ndryshime në Këshillin e Qarkut në shumën prej 200 mijë lekë.

Ndërsa, për qarqet Berat, Lezhë, Fier diferenca e mos realizimi është si rezulta i vlerës së ofertës të paraqitur nga operatorët fitues në tendër në shumën prej 247 mijë lekë

7. Programi “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2015 për këtë program, që përfaqëson 99 përqind të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 96 përqind
- Shpenzimet kapitale 99 përqind
- **Gjithsej 99 përqind**

Janë parashikuar për këtë periudhë 10 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Fakti i vitit 2015		
		Në milionë lekë	Ne %	Statusi i realizimit
Përmirësimi infrastrukturës së Porteve Peshkimit	8	7	88	Plotësisht
Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore	14	14	100	Plotësisht
Sistemi Blu Box i kontrollit monitorimit të mjeteve peshkimit	18	16	83	Plotësisht
Kontrollet e Inspektoratit të Peshkimit në subjektet e peshkimit të licencuara	18	18	100	Plotësisht
Rasate të peshkimit të kultivuara në Ohër dhe Prespë	4	4	100	Plotësisht
Menaxhimi i infrastrukturës	41	40	98	Plotësisht
Kontrata dhe leje për peshkim	1	1	100	Plotësisht
Rasate të blera peshq të familjes së krapit	0	0	0	Aspak
Kontrolle të ushtruara nga QNOD	0	0	0	Aspak
Ndërtimi Portit të ri Peshkimit në Durrës	380	379	100	Plotësisht
TOTALI	484	479	99	

Ky program për vitin 2015, ka të planifikuar 402 milion lekë fond investime, nga të cilat 359 milion lekë janë financim i huaj me realizim financiar 358 milion lekë, 16 milion lekë kosto lokale me realizim financiar 16 milion lekë, 19 milion lekë tvsh dhe realizimi financiar është është 19 milion lekë pra rezulton 99% totali i investimeve për këtë program

Realizimi sipas produkteve të programit “Mbështetje për Peshkim” paraqitet si më poshtë:

Produkti: Përmirësimi i infrastrukturës së Porteve të Peshkimit.

Plani për vitin 2015:	8 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	6 milion lekë
Plani për vitin i produktit:	7 aktivitete	Fakti për vitin 2015 i produkteve:	7 aktivitete

Ka nisur puna për zbatimin e 7 projekteve është duke u punuar për realizimin e tyre.

Produkti: Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore.

Plani për vitin 2015:	14 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	14 milion
Plani për vitin i produktit:		Fakti për vitin 2015 i produkteve:	
Dok.Strategjise se sektorit		Dok.Strategjise se sektorit	

Produkti: Sistemi i kontrollit të monitorimit të mjeteve të peshkimit (Blu box):

Plani për vitin 2015:	18 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	15 milion lekë
Plani për vitin i produktit:	1 sistem	Fakti për vitin 2015 i produkteve:	1 sistem

Produkti: Ndërtimi i Portit të Ri të peshkimit në Durrës, me financim nga BIZH

Plani për vitin 2015:	380 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	379 milion lekë
Plani për vitin i produktit	5.000 ml	Fakti për vitin 2015 :	5.000 ml

Produkti: Kontrolle te ushtruara nga QNOD.

Plani për vitin 2015:	6 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	Ky proces nuk varet nga buxheti i inat.tone
Plani për vitin i produktit:	1800 kontrole	Fakti për vitin 2015 :	

Për kryerjen e një procesi sa më të mire të monitorimit të aktivitetit të peshkimit me qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve peshkore si dhe për zbatimin e ligjit dhe rregulloreve të sektorit të peshkimit.

Produkti: Rasate të blera peshq te familjes së krapit (ballgjerë, krap kulture, amur).

Plani për vitin 2015:	4 milion lekë	Fakti për vitin 2015	0 milion lekë
Plani për vitin i produktit:	400000 rasate	Fakti për vitin 2015 :	0 rasate

Proçesi i tenderimit nuk është realizuar.

Produkti: Kontrata dhe leje për peshkim.

Plani për vitin 2015:	1 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	1 milion lekë mije LEK
Plani për vitin i produktit:	300 kontrata	Fakti për vitin 2015:	231 kontrata(Leje)154 aktivitete ne det dhe 77 kontrata ne ujerat e brendshme dhe akuakulture

Për të bërë të mundur sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të detare dhe atyre të brendshme shqyrtohen kërkesat e ardhura nga subjektet për shqyrtimin e aktivitetit të peshkimit në det dhe në ujërat e brendshme. Gjatë kësaj periudhe kanë plotësuar dhe u është dhënë leja për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturë 154 subjekte.

Produkti: Menaxhimi i infrastrukturës.

Plani për vitin 2015:	41 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	40 milion lekë
Plani për vitin i produktit:	4 porte	Fakti për vitin 2015 :	4 porte

Eshte kryer procesi i menaxhimit te porteve dhe ekonomive te rasatit

Produkti i Rasate te peshkimit të kultivuara në Ekonomitë e Linit dhe të Zvezdës

Plani për vitin 2015:	4 milion lekë	Fakti për vitin 2015	4 milion lekë
Plani për vitin i produktit:	800.000 rasate	Fakti për vitin 2015	800.000 rasate

Procesi është kryer plotesisht

Kontrolle te inspektoriatit te peshkimit ne subjektet e peshkimit te licensuara.

Plani për vitin 2015:	18 milion lekë	Fakti për vitin 2015:	18 milion lekë
Plani për vitin:	2500 kontrolle	Fakti për vitin 2015 i produkteve:	2500 kontrolle

Me qëllim zbatimin e Ligjit të Peshkimit Nr. 64/2012 dhe në zbatim të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore kryehet monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturë. Kontrollet e inspektimit janë kryer në bashkëpunim me inspektoriatet e rretheve.

Projekti ka realizim faktik financiar të financimit të huaj 100%.

Nëpërmjet këtij projekti ndërtohet një port strategjik plotësisht operativ ku anijet e peshkimit të shkarkojnë ngarkesën dhe të ankorohen në mënyrë të sigurt.

Gjatë vitit 2015 u kryen si me poshte vijon:

Përfundoi Loti II i punimeve të portit

- u ndërtuan tre pontile sipas projektit

- me kërkesë të ministrisë dhe me miratimin e Bankës Islamike u ndërtuan pontilet lundruese për të rritur kapacitetin ankorues të portit

- përfundoi plotësisht godina e zyrave dhe ambienteve ndihmëse për peshkimin.

U bënë gjithë lidhjet elektrike, të ujërave dhe të kanalizimeve me rrjetin qendror të qytetit

- meqenese nga financimi Istisna tepruan fonde, me kerkesen e Ministrise se Bujqesise dhe me miratimin e Bankes Islamike u be projekti dhe u ndertua pjesa me e madhe e merkatos se peshkut me 17 dhoma frigoriferike

- brenda këtij viti janë çertifikuar punimet për Lotin I dhe pjesërisht për Lotin II.

Vazhdon të jetë në proces certifikimi përfundimtar i projektit

- megjithë kërkesat dhe informacionet e dërguara, problem gjatë vitit 2015 ishin fondet e KL dhe TVSH, me një mungesë të theksuar gjatë 2015-s, në pritje për tu disbursuar gjatë këtij viti.

8- Programi : "Administrimi i Ujrave"

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2015 për këtë program, që përfaqëson **86 përqind** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 86 përqind
- Shpenzimet kapitale 86 përqind
- **Gjithsej 86 përqind**

Janë parashikuar për këtë periudhë 16 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2015 në mln lekë	Realizimi i 12 m i vitit 2015		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Akte ligjore dhe nenligjore të hartuara dhe miratuara	6	3	50	Pjesërisht
Raport për gjendjen shtreterve të lumenjve dhe propozimi i masave;	9	6	67	Plotesisht
Raporti financiar për mbledhjen e të ardhurave	6	4	67	Plotesisht
Takime mbi marrëveshjet me vendet fqinj	2	1,5	75	Plotesisht
Raport vlerësimi dhe masash mbi Monitorimin e procedurës së paisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore	7	6	86	Plotesisht
Regjistri Kombëtar të lejeve të burimeve ujore	5	5	100	Plotesisht
Raport analitik mbi bazën e Monitorimit I demëve të shkaktuar nga hedhja e inerteve në bregdet dhe zonat turistike	4	3,5	88	Plotesisht
Raport për mbledhjen për monitorimin	11	9	82	Plotesisht
Raport vlerësimi për verifikimin e kushteve të lejes	12	11	92	Plotesisht
Raport monitorimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor	11	10	91	Plotesisht
Inspektime për mbrojtjen e burimeve ujore	10	10	100	Plotesisht
Inspektime për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e inerteve lumore	3	2	67	Plotesisht
Inspektime për shkarkimin e ujërave të ndotura	5	5	100	Plotesisht
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore	37	31	84	Plotesisht
Kadastra e Ujit	37	34	92	Plotesisht
Hartimi i planeve të menaxhimit të baseneve Drin-Buna dhe Semani, Vjosa	27	24	98	Plotesisht
TOTALI	192	165	86	

Ky program përfshin projektin “Burimet Ujore dhe Ujitja “ Grant nga qeveria Suedeze dhe kredi nga IBRD ka një realizim financiar 99 %.

Programi i Administrimit të Ujërave mbështet administrimin e burimeve ujore si një nga burimet natyrore me të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për jetën dhe zhvillimin social-ekonomik të vëndit, për një zhvillim të qëndrueshëm të rezervave ujore, për të kufizuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga aktivitet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktiviteteve të popullsisë në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjëve nga shfrytëzimi pa kriter i tyre. gjithashtu mbështet bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për administrimin e rezervave ujore, që shtrihet në kufijtë midis vendeve.

Ndarja e shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për buxhetin 2015 (vjetore) është bazuar në përcaktimin e produkteve si prioritete duke synuar në përmirësimin dhe forcimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ujërave sipërfaqësorë, qofshin të përkohshëm apo të përhershëm, të ujërave të brendshme detare, ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre, si dhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian,

Rehabilitimin e shtretërve të lumenjeve si rezultat i aktivitetit të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore.

Evidentimi i dëmeve të shkaktuar nga hedhja e inerteve në bregdet dhe zonat turistike.

Forcimi dhe zbatimi i programit të masave për rehabilitimin e shtretërve të lumenjëve.

Realizimi i të ardhurave nga përdorimi i burimeve ujore .

Realizimin e marveshjeve për ujërat ndërkufitare me vëndet fqinje në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Monitorimi i procedurës së paisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore.

Hartimi i regjistrit Kombëtar të lejeve të burimeve ujore .

Inspektimi dhe verifikimi i kushteve në lejet e miratuara nga KBU-ja, për përdoruesit e burimeve ujore dhe inerteve lumore, konform legjislacionit në fuqi, marrja e masave për mbrojtjen e tyre .

Inspektimi për evidentimin e të gjithë përdoruesve të burimeve ujore pa leje, evidentimi i të gjithë burimeve ujore nëntokësore (pus-shpime) dhe sipërfaqësore, si dhe për shfrytëzimin pa leje të inerteve lumore.

Bashkëpunimi dhe koordimi i punës me institucionet që përdorin dhe monitorojnë burimet ujore, për një përdorim sa më racional dhe efikas të tyre.

Hartimi i programit kombëtar të monitorimit të mjedisit me treguesit e gjendjes, të presionit dhe të ndikimit në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

Monitorimi dhe rakordimi i punës me ABU për implementimin e legjislacionit. Mbrojtja e bregdetit nga erozioni.

Pregatitja e Kadastrës Ujore të burimeve ujore, Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe pregatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin-Bunë dhe Seman.

Ky program përfshin projektin “Burimet Ujore dhe Ujitja “ Grant nga qeveria Suedeze dhe kredi nga IBRD ka një realizim financiar 99 %. Arritjet e projektit të “Burimet Ujore dhe Ujitja “ si:

- Përgatitja e strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore – drafti strategjia është dorëzuar nga konsulentët dhe është në process miratimi, kontrata përfundon në fund të vitit.

- Përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve për basenet e Drini-Buna dhe Semani – është dorëzuar raporti praparak nga konsulenti, drafti i parë i dokumentit të planeve të baseneve pritët brenda 12 muajve.

- Krijimi i kadastrës ujore, kontrata është në zbatim.Procedura e tenderimit është bërë nga Ministria e Mjedisit.Konsulenti ka dorëzuar dhe është pranuar Raporti Paraparak;Raporti i modelit logjik dhe fizik të kadastrës ujore është dorëzuar nga konsulenti dhe është në process miratimi;Raporti: propozimi për hardëare dhe softëare janë dorëzuar dhe janë në proces shqyrtimi.

- _Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit Konsulenti ka dorëzuar dhe është pranuar Raporti Paraparak;

Raporti: Pjesët përshkruese mbi funksionimin e komponentëve dhe nënkomponentëve të sistemit të monitorim – vlerësimit është dorëzuar nga Konsulenti dhe është në proces miratimi.

Raporti: Mjetet që përdoren për mbledhjen e informacionit sasior dhe cilësor është dorëzuar nga Konsulenti dhe është në proces miratimi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VOJO BREGU

